



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1215 / 18 prot.

Tiranë, më 30.05.2025

VENDIM

Nr. 42, datë 30.05.2025

PËR

“MIRATIMIN E RREGULLAVE MBI DHËNIEN E PËLQIMIT PËR PËRDORIMIN NGA PALËT E TRETA TË STEMËS SË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË”

Në bazë të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3, 34 dhe 38, të Statutit të UMT-së, neni 5, 8, 26 si edhe Relacionit të Grupit të punës nr. 1237 prot datë 30.05.2025, Tiranë pas diskutimeve të zhvilluara në mbledhjen e datës 30.05.2025,

VENDOSI:

I. Të miratojë rregullat mbi dhënie e pëlqimit për përdorimin nga palët e treta të stemës (logos) së Universitetit të Mjekësisë Tiranë, si më poshtë:


1. Ndërmjet palëve të ketë marrëveshje bashkëpunimi në fuqi ose të jetë në proces nënshkrimi një e tillë;
2. Përputhshmëria e veprimtarisë/aktivitetit që do të organizohet nga pala e tretë me vlerat dhe misionin e UMT-së;
3. Qëllim i qartë dhe transparent për përdorimin e stemës;
4. Kontributi i palës së tretë;
5. Aktiviteti dhe përmbajtja;
6. Niveli i angazhimit të UMT-së në aktivitet, me pjesëmarrje nga personeli apo studentët;
 - 6.1 Pjesëmarrës të personelit të UMT në panelin drejtues të aktivitetit të paktën në masën 10 %;
 - 6.2 Pjesëmarrës të personelit dhe studentëve të UMT si referues/lektorë në prezantimin e punimeve të tyre të paktën në masën 10%.
 - 6.3 Pjesëmarrje pa pagesë e studentëve të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, deklaruar nga i interesuari.
7. Përfitimet për institucionin (UMT);
8. Parandalimi i keqpërdorimit të stemës;
9. Transparenca dhe raportimi në fund të aktivitetit;
10. Pëlqimi zyrtar, etj.

- II. Të miratojë formularin tip të vlerësimit “Për propozimin e dhënies së pëlqimit për përdorimin nga palët e treta, të stemës së UMT-së” (shtojca nr.1).
- III. Ngarkohet për zbatimin e këtij Vendimi, Administratori i UMT-së si dhe strukturat përkatëse në Rektoratin e UMT-së.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

PROF. DR. XHELADIN DRAÇINI



Shtojca nr. 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORATI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/202__

**FORMULAR VLERËSIMI PËR PROPOZIMIN E DHËNIES SË PËLQIMIT PËR
PËRDORIMIN NGA PALËT E TRETA TË STEMËS SË UMT-SË**

Pala e interesuar: _____

1. A ka pala e tretë një marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruar me UMT-në?

- ☐ Po
☐ Jo

• A ka pala e tretë interes për të nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me UMT?

- ☐ Po
☐ Jo

2. Përputhshmëria e propozimit me misionin dhe objektivat e institucionit

• A është aktiviteti i propozuar në përputhje me misionin dhe objektivat e UMT?

- ☐ Po
☐ Jo

• A promovon aktiviteti edukimin, kërkimin shkencor, inovacionin, apo çështje të tjera me rëndësi shoqërore?

- ☐ Po
☐ Jo

3. Qëllimi i qartë dhe transparent

- A është/janë përshkruar qartë arsyet përse pala e tretë kërkon të përdorë stemën e UMT-së?
☐ Po
☐ Jo
- A është përdorimi i stemës për qëllime informuese, promovuese?
☐ Po
☐ Jo
- A është përdorimi i stemës për qëllim bashkëpunimi?
☐ Po
☐ Jo

4. Kontributi i palës së tretë

- A është i njohur kontributi që ka pala e tretë në fushën në të cilën ushtron aktivitetin?
☐ Po
☐ Jo
- A mund të ndikojë negativisht përdorimi i stemës nga kjo palë në imazhin e institucionit?
☐ Po
☐ Jo

5. Aktiviteti dhe përmbajtja

- A është veprimtaria/aktiviteti i propozuar në përputhje me etikën dhe me standardet institucionale?
☐ Po
☐ Jo
- A ka veprimtaria/aktiviteti përmbajtje politike, komerciale apo të diskutueshme që mund të cenojnë imazhin e institucionit?
☐ Po
☐ Jo
- A është veprimtaria/aktiviteti shkencor, kulturor, arsimor apo me përfitime shoqërore?
☐ Po
☐ Jo

6. Përputhshmëria me rregulloret dhe ligjet

- A respekton pala e tretë rregullat e përdorimit të stemës dhe politikat institucionale?
☐ Po
☐ Jo
- A është përdorimi i stemës në përputhje me ligjet për pronësinë intelektuale dhe markat tregtare?
☐ Po
☐ Jo

7. Angazhimi i institucionit në aktivitet

- A ka një formë bashkëpunimi midis institucionit dhe palës së tretë në aktivitet?
☐ Po
☐ Jo
- Koment: _____
- A do të jetë i përfshirë personeli akademik, administrativ, studentët apo infrastruktura e institucionit?
 - a. Pjesëmarrës të personelit të UMT të paktën në masën 10 % në panelin drejtues të aktivitetit;
☐ Po
☐ Jo
 - b. Pjesëmarrës të personelit dhe studentëve të UMT të paktën në masën 10 % si referues/lektorë në prezantimin e punimeve të tyre.
☐ Po
☐ Jo
 - c. Pjesëmarrje pa pagesë e studentëve të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe sa është numri i studentëve të UMT-së deklaruar nga pala e interesuar?
☐ Po
☐ Jo
 - A do të përdoret infrastruktura e institucionit për zhvillimin e aktivitetit?
☐ Po

☐ Jo

8. Përfitimet për institucionin

- A sjell ky aktivitet përfitim për institucionin, personelin apo studentët e tij (kontributi, fizibiliteti, lidhja me komunitetin)?

☐ Po

☐ Jo

- A ka përfitime afatgjata për institucionin nga ky bashkëpunim/mbështetje?

☐ Po

☐ Jo

9. Parandalimi i keqpërdorimit

- A ka mekanizma për të monitoruar që stema nuk do të keqpërdoret (p.sh., për qëllime fitimi të paligjshëm apo mashtruese)?

☐ Po

☐ Jo

- A është e përcaktuar qartë se si dhe ku do të përdoret stema dhe në çfarë konteksti?

☐ Po

☐ Jo

- A është e përcaktuar qartë se për studentët e UMT nuk do të ketë pagesë për pjesëmarrje në të gjitha nivelet e pjesëmarrësve në aktivitetet?

☐ Po

☐ Jo

10. Transparenca dhe raportimi

- A është pala e tretë e gatshme të raportojë mbi përdorimin e stemës dhe rezultatet e aktivitetit?

☐ Po

☐ Jo

- A do të sigurohen paraprakisht materialet promovuese për rishikim nga ana e institucionit?

☐ Po

☐ Jo

11. Pëlqimi zyrtar

- **Rekomandim nga GP** për dhënien e pëlqimit zyrtar në dhënien përdorimin e Stëmës (Logos) së UMT-së
 - ☐ Miratohet
 - ☐ Refuzohet
 - Komentë shtesë: _____